



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Bi Prot.
Dep. <u>20/DPK</u>	Prot No <u>01-1262/15</u>
Nr. i faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>05.05.2015</u>
KOSHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.04.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-506/15, për znj. Merita Surkishi – Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë pretendimet për ekzistimin e konfliktit të interesit, në procesin e zgjedhjes së Komisionit të Aksionarëve për Ndërmarrjet Publike Lokale.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, pas denoncimit nga pala e tretë për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 –02- 506/15, për zyrtaren e lartë, znj. Merita Surkishi – Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji PKI).

Znj. Surkishi është dyshuar për konflikt interesi në procesin e zgjedhjes së Komisionit të Aksionarëve për Ndërmarrjet Publike Lokale. Ajo ka qenë pjesë e vendimmarrjes në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Prishtinës të datës 14 Janar 2015 dhe seancën e rregullt të datës 05 Shkurt 2015, në të cilat është diskutuar lidhur me shkarkimin dhe emërimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve.

Në trajtimin e këtij rasti, fillimisht Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), i ka dërguar znj. Surkishi shkresën zyrtare, njoftim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ajo është paraqitur në takim në zyrat e AKK-së.

Në takim e kemi njoftuar zyrtaren me pretendimet e palës denoncuese në lidhje me situatën e pretenduar të konfliktit të interesit.

Nga takimi me znj. Surkishi dhe nga Ekstrakti i Procesverbalit të Mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe, kemi vërtetuar se së pari janë shkarkuar Anëtarët e Komisioneve të Aksionarëve ndërsa, më pas është miratuar Vendimi për caktimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale të Prishtinës.

Prandaj, nuk qëndron pretendimi i denoncuesit të rastit se, veprimi i znj. Surkishi në votimin e Komisionit të Aksionarëve paraqet konflikt interesi për faktin se ajo është e punësuar në Ndërmarrjen "Pastrimi".

Kjo për arsye se të qenurit e punësuar në atë Ndërmarrje, nuk ia mohon të drejtën për të votuar për Komisionin e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale.

Megjithatë zyrtarja e lartë znj. Surkishi, në rast të paraqitjes eventuale të ndonjë situatë me konflikt "rast për rast" të interesit në të ardhmen, është e obliguar të bëjë deklarinimin paraprak të interesave private dhe të tërhiqet nga vendimmarrja konform nenin 13, paragrafit 1, 2 dhe 3 të Ligjit PKI.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

